REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 124/20
Datë/Datum. 07.04.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.124/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi -Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: N.N. "PRISHTINA"– Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: "CONDES" SH.P.K. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi dhe riparimi i objekteve ushtarake në Prishtinë e ndare ne dy pjese: Pjesa 1 Ndërtimi i garazheve për autoambulanca Kazerma e FSK Prishtinë, Pjesa 2 Riparimi Lyrja e Objektit të BMO-së Kazerma e FSK-së Prishtinë" me nr. të prok:217-19-3374-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/Ministria e Mbrojtjes (MM), më datën: 01.04.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: N.N. "PRISHTINA"– Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi dhe riparimi i objekteve ushtarake në Prishtinë e ndare ne dy pjese: Pjesa 1 Ndërtimi i garazheve për autoambulanca Kazerma e FSK Prishtinë, Pjesa 2 Riparimi Lyrja e Objektit të BMO-së Kazerma e FSK-së Prishtinë" me nr. të prok: 217-19-3374-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Ministria e Mbrojtjes (MM).

II. **VËRTETOHET,** njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi dhe riparimi i objekteve ushtarake në Prishtinë e ndare ne dy pjese: Pjesa 1 Ndërtimi i garazheve për autoambulanca Kazerma e FSK Prishtinë, Pjesa 2 Riparimi Lyrja e Objektit të BMO-së Kazerma e FSK-së Prishtinë" me nr. të prok: 217-19-3374-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Mbrojtjes.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: N.N. "PRISHTINA"– Prishtinë aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues N.N. "PRISHTINA"– Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 19.02.2020 me nr. 124/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi dhe riparimi i objekteve ushtarake në Prishtinë e ndare ne dy pjese: Pjesa 1 Ndërtimi i garazheve për autoambulanca Kazerma e FSK Prishtinë, Pjesa 2 Riparimi Lyrja e Objektit të BMO-së Kazerma e FSK-së Prishtinë" me nr. të prok: 217-19-3374-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Mbrojtjes (MM), duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 56, dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe

- Neni 39 të RrUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 03.03.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt:10.03.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim: Me dt:23.09.2019, Paneli shqyrtues ka marruar Vendim, Psh.nr.493/19, ku e ka aprovuar pjesërisht ankesën e OE "CONDES" SHPK, dhe e ka anuluar Njoftimin për dhënie të kontratës për Lot 1.

Me dt:20.11.2019, OE "CONDES" SHPK, ankesë me nr.827/19 në OSHP, ku deklaron se nuk është respektuar Vendimi i Panelit shqyrtues Psh.nr.493/19, i datës: 23.09.2019.

Me dt:22.01.2020, Organi shqyrtues i Prokurimit nxjerrë Urdhëresë Psh. nr.827/19, ku aprovohet si e bazuar ankesa e grupit të OE"CONDES" SHPK & NNP "EURO CONSTRUCTION & JETMIRI" SHPK, ndërsa

Obligon autoritetin kontraktues Ministria e Mbrojtjes, që ta zbatoj Vendimin Psh.nr.493/19, i datës:23.09.2019.

Eksperti shqyrtues, sqaron se tek pjesa e arsyetimit të Urdhëresës Psh. nr.827/19, të dt:22.01.2020, sqarohet: Seanca dëgjimore është mbajtur me datën 13.01.2020, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga autorizim inicimit të aktivitetit të prokuronit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë. Paneli Shqyrtues sqaron se konform nenit 59 të Ligjit Nr. O5/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e LPP-së, si ligj bazik, duhet ta trajtojnë një çështje si të gjykuar "resjudicata" në qoftë se në pikëpamje subjektive dhe objektive rasti është përsëritur.
Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues vëren që kriteri i pikëpamjes subjektive është plotësuar sepse palët procedurale janë të njëjtat si në rastin e vendosur PSH. Nr. 493/19 të datës:23.09.2019, si dhe kriteri i pikëpamjes objektive është plotësuar sepse Lënda është e njëjtë, respektivisht shkaku i eliminimit të OE Ankues është i përsëritur si në rastin PSH. Nr. 493/19. Në të njëjtën linjë të argumentimit qëndron dhe mendimi i ekspertit shqyrtues.

Në këtë drejtim, Paneli Shqyrtues i rikujton Autoriteti Kontraktues se neni 56, paragrafi 3 i LPP-së, parasheh që Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedural e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Si pasojë OE Ankues nuk duhet të eliminohet mbi bazat të cilat nuk janë të përcaktuara si kritere në dosje të tenderit, gjegjësisht, mos-plotësimi e përshkrimit të çmimeve në paramasë dhe parallogari nuk ka qenë kriter i dosjes së tenderi andaj nuk mund të jetë shkak për eliminim.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që ta zbatoj në tërësi vendimin PSH. Nr. 493/19, të datës 23.09.2019 dhe po ashtu të respektohet neni 56 LPP-së. Paneli Shqyrtues njofton Autoriteti Kontraktues që të ndërmerr masa për zbatimin e vendimit të sapo përmendur brenda pesë (5)ditëve, në të kundërtën Paneli Shqyrtues detyrohet që të shqiptoj masa kundër Autoriteti Kontraktues në kuptim të nenit 105 dhe 131 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh Vendimin Psh.nr.493/19 dhe Urdhëresën Psh.nr.827/19, ankesa e OE ankues NN "PRISHTINA", është e përfunduar sepse kemi të bëjmë me kërkesë e cila nuk është e cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pa bazuar, dhe të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin i AK-së.

Autoriteti Kontraktues, nuk është deklaruar, se pajtohet apo nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 13.03.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues si me poshtë:

Me date 11.03.2020 kemi pranuar Raportin e Ekspertit shqyrtues te OSHP-se, lidhur me pretendimet ankimore te pararshtruara kunder Vendimit te AK- Ministrise se Mbrojtjes lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull te kontrates; Ndertimi I garazheve per autoambulanca ne kazerma te FSK-se, tenderi me nr. te prokurimit 217-19-3374-5-2-1 dhe numer te brendshem 21700/19/026/521
Pas analizave te raportit , ne si pararshtrues te ankeses kemi konstatuar se Eksperti shqyrtues nuk I ka shqyrtuar pretendinimet tona ankimore te parashtruara ne ankese dhe te vertetuara me dëshmi dhe fakte. Nuk pajtohemi me Mendimin e Ekspertit shqyrtues te dhëne ne Raportin e dates 11.03.2020.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 03.04.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të nenit 59 të Ligjit Nr. O5/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e LPP-së, si ligj bazik, duhet ta trajtojnë një çështje si të gjykuar "resjudicata" në qoftë se në pikëpamje subjektive dhe objektive rasti është përsëritur. Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron që kriteri i pikëpamjes subjektive është plotësuar sepse palët procedurale janë të njëjtat si në rastin e vendosur PSH.Nr. 493/19 të datës:23.09.2019, si dhe kriteri i pikëpamjes objektive është plotësuar sepse lënda është e njëjtë, respektivisht shkaku i eliminimit të OE ankues është i përsëritur si në rastin PSH.Nr. 493/19. Në këtë drejtim, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues i ka rikujtuar Autoritetit Kontraktues se neni 56, paragrafi 3 i LPP-së, parasheh që tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në bazë të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pra, si pasojë operatorët ekonomik nuk duhet të eliminohen mbi bazat të cilat nuk janë të përcaktuara si kritere në dosje të tenderit, më saktë, mos-plotësimi i përshkrimit të çmimeve në paramasë dhe parallogari nuk ka qenë kriter i dosjes së tenderi. Andaj, nuk mund të jetë shkak për eliminim.

Megjithatë, Paneli Shqyrtues sqaron se për shkak të paqartësive të OE ankues, këtë pretendim e trajton

si pjesërisht të bazuar, mirëpo nuk ndikon në ndryshim të gjendjes faktike.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues i ka kërkuar Autoriteti Kontraktues që ta zbatoj në tërësi vendimin PSH. Nr. 493/19, të datës 23.09.2019 dhe po ashtu ka kërkuar që të respektohet neni 56 LPP-së.

Paneli Shqyrtues sqaron se edhe eksperti shqyrtues ka vlerësuar se duke pasur parasysh Vendimin Psh.nr.493/19 dhe Urdhëresën Psh.nr.827/19, ankesa e OE ankues NN "PRISHTINA", është e përfunduar sepse kemi të bëjmë me kërkesë e cila nuk është e cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues gjatë rivlerësimit të ofertave ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në bazë të kërkesave të përcaktuara në dosje të tenderit në bazë të nenit 59 të LPP-së. Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka pasur në konsideratë që të siguroj që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Po ashtu, paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Ministria e Mbrojtjes (MM);

1x1 OE-N.N. "PRISHTINA"– Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.